



GRANTE TË BASHKËFINANCUARA PËR

**KOMERCIALIZIMIN
E INOVACIONEVE**

QËLLIMI I THIRRJES

Të inkurajojë rritjen e aktiviteteve për hulumtim dhe zhvillim në sektorin privat, të inkurajojë bashkëpunimin midis sektorit privat, institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve kërkimore-shkencore, si dhe forma të tjera bashkëpunimi për komercializimin e inovacioneve.

ÇFARË PROJEKTE MBËSHTESIM



Instrumenti është i dedikuar për sipërmarrjet që duan të zhvillojnë një produkt, shërbim ose proces inovativ, vetëm ose në bashkëpunim me një ndërmarrje dhe/ose institucion tjetër që ushtron arsimin e lartë, gjegjësisht veprimtari kërkimore-shkencore.

Instrumenti ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet e regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim të zhvillimit dhe implementimit të zgjidhjeve inovative, duke përfshirë mbështetjen për ndërmarrjet me potencial të lartë rritjeje.

Mbështetja nëpërmjet këtij instrumenti do t'u jepet projekteve që kanë qëllim të qartë komercial, që janë në fazën e prototipit deri në fazën para-komerciale (para tregtimit).



BUXHETI

Buxheti ipërgjithshëm i hirjes:
8.000.000 euro në kundërvlerë në denarë.

Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik ofron mbështetje financiare në shumën maksimale prej 20.000.000 denarë.

Kohëzgjatja e projektit për të cilin janë ndarë mjetet financiare nëpërmjet këtij instrumenti mund të jetë deri në 24 muaj.

DERI NË
70%

për ndërmarrjet numri mesatar i të punësuarve të të cilëve është deri në 50 punonjës dhe të ardhurat vjetore të të cilave në dy vitet e fundit janë më pak se 2.000.000 euro

DERI NË
60%


për ndërmarrjet numri mesatar i të punësuarve të të cilave është nga 50 deri në 250 dhe të ardhurat vjetore të të cilave në dy vitet e fundit janë më të mëdha se 2.000.000 euro.



KRITERET E PRANUESHMËRISË SË

APLIKANTIT

- të jetë shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ardhurat vjetore të aplikantit nuk duhet të kalojnë 10.000.000 euro, sipas raporteve financiare për dy vitet e mëparshme fiskale;
- numri mesatar i të punësuarve sipas raporteve financiare për dy vitet e mëparshme nuk duhet të kalojë 250 punonjës;
- të mos jetë i lidhur (sipas Ligjit për shoqëritë tregtare) me një ndërmarrje tjetër, të ardhurat vjetore të së cilës i kalojnë 10.000.000 euro dhe numri mesatar i të punësuarve nuk i kalon 250 në dy vitet e mëparshme fiskale, me përjashtim të rastit të lidhjes me një institucion të arsimit të lartë, gjegjësisht institucion kërkimor shkencor;
- aplikantët me më shumë se 3 vite ekzistencë deri në momentin e aplikimit nuk duhet të kenë pësuar humbje sipas pasqyrave financiare për dy vitet e fundit kalendarik, në përputhje me nenin 14 paragrafi 1 alineja 5 nga Rregullorja dhe dispozitat e Konkursit publik;
- aplikanti, deri në momentin e aplikimit për thirrjen publike, nuk ka projekt aktual (aktiv) që mbështetet financiarisht nga Fondi në bazë të ndonjë prej instrumenteve mbështetëse;
- ndaj tij nuk ka filluar procedura e falimentimit ose e likuidimit;
- të ketë shlyer detyrimet e maturuara në bazë të detyrimeve dhe kontributeve publike;
- ndaj tij nuk ka filluar procedura për ekzekutimin e detyrueshëm të kërkesave monetare të maturuara;
- të përmbushë kërkesat e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe kushtet e nenit 6 të Dekretit për kushtet dhe procedurën e dhënies së ndihmës horizontale.



AKTIVITETET E PRANUESHME PËR FINANCIM

- aktivitetet e testimit;
- aktivitetet në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- dizajni;
- zhvillimi i linjave pilot;
- aktivitetet që lidhen me sigurimin e cilësisë;
- aktivitetet e marketingut dhe shitjes (që synojnë sjelljen e inovacionit në gatishmërinë dhe pjekurinë e investimeve për futjen në treg);
- aktivitetet për hulumtim dhe zhvillim.





SHPENZIMET E PRANUESHME PËR FINANCIM

- pagat bruto për punonjësit e aplikantit dhe anëtarët e konsorciumit që do të angazhohen në projekt. Shumat e pagave bruto të punonjësve të angazhuar në projekt duhet të korrespondojnë me praktikën e vendosura të përfituesit përpara fillimit të projektit, të reduktuara me shumën e subvencionit të mundshëm shtetëror të marrë në bazë të pagës;
- furnizimi dhe/ose marrja me qira e pajisjeve dhe materialeve harxhuese për hulumtim dhe zhvillim;
- shërbimet e nënkontraktuara për hulumtim dhe zhvillim;
- angazhimin e ekspertëve/konsulentëve për hulumtim dhe zhvillim;
- angazhimin e konsulentëve për nevoja të tjera që lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme të projektit;
- përgatitja dhe dorëzimi i aplikacionit për patentë, mbrojtje të markës tregtare dhe/ose dizajn industrial;
- shpenzimet për marketing;
- mbështetje për zyra dhe biznes në një shumë maksimale prej 10% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.





EVALUIMI I PROJEKTEVE

FAZA E PARA-PËRZGJEDHJES

Kryhet nga tre ekspertë vendas për projekt. Dy ekspertë nga fushat që korrespondojnë me kriteret e vlerësimit dhe një person nga fusha që korrespondon me propozim projektin.

FAZA E PËRZGJEDHJES

kryhet nga Komisioni i Miratimit të Investimeve, i cili merr vendimin përfundimtar për financimin nëpërmjet këtij Instrumenti.

KRITERET PËR EVALUIMIN E PROPOZIM PROJEKTIT

- ▶ shkalla e inovacionit
- ▶ cilësia e projektit
- ▶ kapaciteti i ekipit të projektit
- ▶ potenciali i tregut
- ▶ ndikimi



MEKANIZMI PËR KTHIMIN E MJETEVE

Çdo pagesë rojaliti bëhet në masën 5% të tëardhurave vjetore të përdoruesit të arritura nga shitja e produktit/shërbimit që është rezultat i projektit, deri në arritjen e kthimit prej 100% të shumës së paguar nga Fondi ose për një periudhë prej pesë vitesh pas përfundimit të projektit, varësisht se cili kusht plotësohet i pari.



DOKUMENTACIONI I PROJEKTIT

- formulari i aplikimit për projektin i plotësuar në mënyrë të duhur;
- formulari i buxhetit të projektit i plotësuar në mënyrë të duhur;
- deklaratë të aplikantit për pranimin e kushteve të Fondit;
- pyetësor për mjedisin jetësor i plotësuar në mënyrë të duhur dhe
- deklaratë të noterizuar të strukturës së pronësisë së aplikantit.

Dokumentacioni që duhet të sigurohet nga aplikanti: biografitë e shkurtra të personave që përbëjnë ekipin e projektit të angazhuar në projekt (për maksimum 5 persona);



AFATI I APLIKIMIT:
DERI MË 04.06.2024 ORA 14:00

INFORMACIONE SHITESË:
KOMERCIJALIZACIJA2024@FITR.MK
WWW.FITR.MK



Republika e Maqedonisë së Veriut
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

